

# BULETINI



PRILL 2024



## Takim për sfidat e gjyqësorit në veri të Kosovës pas largimit të gjyqtarëve serb dhe punëtorëve të tjerë

Largimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ të komunitetit serb të Kosovës, ka lënë një boshllëk të dukshëm në sistemin gjyqësor në veri të Kosovës, duke ngritur shqetësime për vazhdimësinë dhe efektivitetin e proceseve ligjore. Në dritën e këtyre sfidave, OJQ ACDC organizoi takim që synonte të vlerësonte shkallën në të cilën reduktimet e stafit ndikojnë në funksionalitetin e përgjithshëm të institucioneve gjyqësore në veri të Kosovës, duke eksploruar mënyra për të mbështetur dhe fuqizuar gjyqësorin e integruar dhe duke diskutuar të ardhmen e këtyre institucioneve.

Panelistë në takim ishin z. Bislum Gashi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, z. Bekim Veliqi, ushtrues detyre i kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe z. Dushan Radaković, drejtor ekzekutiv i OJQ ACDC.

Gjatë ngjarjes, panelistët theksuan rëndësinë e sigurimit të qasjes në drejtësi për të gjithë qytetarët në veri të Kosovës dhe gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për sfidat me të cilat përballet sistemi gjyqësor në rajon. Takimi u mbështet nga UNMIK-u.



## Konferencë mbi gjuhën e urrejtjes në Kosovë

Më 25 prill, në Prishtinë, OJQ ACDC Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike, realizoi konferencën publike të titulluar "Gjuha e urrejtjes në veri të Kosovës". Në këtë ngjarje u prezantuan gjetjet e hulumtimit të OJQ ACDC, për perceptimin e gjuhës së urrejtjes në mesin e qytetarëve në veri të Kosovës, pasuar nga diskutime mbi rolet e institucioneve kyçe si Këshilli i Evropës, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, së bashku me organizatat e shoqërisë civile, në reagimin ndaj gjuhës së urrejtjes. Panelistët e shquar përfshinin znj. Mary Ann Hennessey, Shefe e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë; Majlindë Sinani Lulaj, Zëvendëse e Avokatit të Popullit në Kosovë; Z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë; dhe z. Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i OJQ ACDC. Konferenca vuri në pah nevojën emergjente për veprim kolektiv për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe nënvizoi rëndësinë e nxitjes së dialogut dhe mirëkuptimit për të ndërtuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe tolerante në Kosovë.



Gjatë ngjarjes, Drejtori Ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković prezantoi hulumtimin e realizuar mbi gjuhën e urrejtjes, që kishte për qëllim të shqyrtojë perceptimet e banorëve për prevalencën dhe ndikimin e gjuhës së urrejtjes në aspekte të ndryshme të jetës së përditshme dhe të ofrojë një analizë të detajuar të gjuhës së urrejtjes në veri të Kosovës.

Gjetjet kryesore tregojnë se gjuha e urrejtjes është e përhapur, veçanërisht në internet, me një përqindje të konsiderueshme të të anketuarve që raportojnë takime personale me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes. Gjetjet e hulumtimit janë të disponueshme në faqen e internetit të OJQ ACDC në të tri gjuhët.

## Avokati i Popullit u takua me përfaqësuesit e OJQ-ve në Gjilan



OJQ ACDC mundësoi takim e radhës ndërmjet Avokatit të Popullit z. Naim Qelaj dhe OJQ-ve lokale, përfaqësuesve të autoriteteve lokale dhe aktivistëve për të diskutuar çështjet e të drejtave të njeriut.

Takimi në Gjilan u fokusua në çështjet brenda juridiksionit të Avokatit të Popullit, me qëllim të mbledhjes së njohurive nga perspektiva e komunitetit dhe përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet Zyrës së Avokatit të Popullit dhe aktiviteteve të shoqërisë civile.

Kjo iniciativë është zbatuar në kuadër të projektit të financuar nga UNMIK-u, që synon rritjen e ndërgjegjësimit për rolin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit, përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet Zyrës së Avokatit të Popullit dhe OJQ-ve dhe ofrimin e një platforme për planifikim dhe avokim të përbashkët për çështjet kyçe të të drejtave të njeriut.

## Policia e Kosovës dhe IPK-ja takohen me qytetarët për dialog dhe transparencë

Më 26 prill, në ambientet e OJQ ACDC, u mbajt diskutim i mbyllur, ku u mbledhën përfaqësues të Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës, qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare. Qëllimi i takimit ishte informimi i banorëve të komunave veriore për rolin, misionin dhe aktivitetet e këtyre institucioneve, si dhe për t'u ofruar atyre mundësinë për të bërë pyetje dhe për të shprehur shqetësimet e tyre.



# Nxitja e bashkëpunimit të të rinjve nga komunitete të ndryshme



OJQ REC & OJQ ACDC organizuan konferencën publike në kuadër të iniciativës për të promovuar dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet studentëve nga komunitetet shumicë dhe joshumicë.

Në konferencë u ndanë edhe gjetjet nga analiza hulumtuese "Bashkëpunimi ndëretnik i të rinjve në Kosovë – sfidat, perspektivat dhe rekomandimet për përmirësim". Ju mund të keni qasje në raport në faqen tonë të internetit.



SRB




ENG



ALB

## Ndërtimi i urave për mirëkuptim ndëretnik



Për të nxitur bashkëpunimin ndëretnik ndërmjet të rinjve në Kosovë, OJQ ACDC organizoi kampin "Ndërtimi i urave për mirëkuptim dhe bashkëpunim ndëretnik". Ky kamp kishte për qëllim të përforcojë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndëretnik në mesin e të rinjve nga rajoni i Mitrovicës dhe ofroi një mundësi për pjesëmarrësit që të thellojnë të kuptuarit e tyre për prejardhjen kulturore, historitë dhe perspektivat e njëri-tjetrit.

OJQ ACDC organizoi gjithashtu vizita kulturore në Deçan dhe Prizren për të thelluar kuptimin e pjesëmarrësve për trashëgiminë kulturore serbe dhe shqiptare, duke nxitur ndjeshmërinë dhe ndjenjën e unitetit mes të rinjve me prejardhje të ndryshme. Një nga iniciativat e projektit ishte edhe realizimi i një grafiti pranë urës kryesore në Mitrovicë, për të zbukuruar zonën dhe për të promovuar shprehjen artistike në mesin e banorëve vendas.

Këto nisma u organizuan në kuadër të një projekti të zbatuar nga OJQ ACDC, përmes Programit të Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM), financuar nga Bashkimi Evropian.

## Kontratat e nënshkruara me praktikantët

OJQ ACDC ka nënshkruar kontrata praktike me avokatë të rinj të përzgjedhur. Gjatë tre muajve të ardhshëm, programi do t'u ofrojë praktikantëve mundësi për të avancuar dhe zgjeruar njohuritë dhe aftësitë e tyre. Programi i praktikës zbatohet në kuadër të projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë", financuar nga INL Kosova, dhe zbatuar nga OJQ ACDC në partneritet me AKTIV.



### PODCAST

Kemi publikuar një podcast të ri me temën e përdorimit të kamerave të trupit të policisë! Qëllimi është që forcat policore të bëhen më profesionale në ruajtjen e rendit dhe ligjit dhe kamerat të përdoren për të ruajtur regjistrimet dhe për të përmirësuar transparencën. Dëgjoni podcast-in në kanal tonë në YouTube dhe mësoni më shumë rreth kësaj teme të rëndësishme.

## Publikimi i OP-ED-ëve



Në prill publikuam 8 (tetë) tekste për të nxitur mirëkuptimin, vlerësimin dhe përfshirjen përmes formave të ndryshme të shprehjes kulturore dhe artistike. Këta artikuj përfshinin një sërë temash, duke vë në pah fuqinë e leximit, diversitetin kulturor, rëndësinë e gjuhës në formësimin e identitetit, një ngjarje kulturore që promovon shprehjen artistike, rolin e artit në nxitjen e kohezionit social dhe historinë dhe evolucionin e grafiteve si një formë arti. Tekstet janë të disponueshme në faqen tonë të internetit.

## Iniciativat për dialog ndëretnik në vetëqeverisjen lokale

Në kuadër të projektit "Promovimi i dialogut ndëretnik në pushtetin lokal", i financuar nga NED, OJQ ACDC zbatoi katër iniciativa në komunat e Zveçanit dhe Mitrovicës së Veriut. Nëpërmjet nismave të përbashkëta, si aksionet e pastrimit dhe ngjarjet kulturore, komunitetet demonstruan aftësinë e tyre për të kapërcyer dallimet dhe për të punuar së bashku për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë. Broshura mbi këto iniciativa është e disponueshme në faqen tonë të internetit në të tri gjuhët.



## Takime

Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i OJQ ACDC, mori pjesë në takimin e Lord Peach me OJQ-të serbe të Kosovës për të dëgjuar pikëpamjet e tyre mbi situatën aktuale politike dhe të sigurisë, duke përfshirë disa nga sfidat me të cilat po përballen aktualisht.



Aleksandar Rapajiq, drejtor i programit në OJQ ACDC, mori pjesë në një takim me deputetët e Komisionit për Punë të Jashtme, Lia Quartapelle dhe Emanuele Loperfido, të cilat ishin takuar me përfaqësues të shoqërisë civile nga Kosova gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë.



Aleksandar Rapajiq ka marrë pjesë edhe në një takim me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, Jonathan Hargreaves dhe përfaqësues të OJQ-ve. Kjo ishte vizita e parë e ambasadorit në Mitrovicën e Veriut, me qëllim të angazhimit me serbët e Kosovës.



Drejtori Ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković u takua me Komisioneren për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva Dërmaku, dhe Drejtoren e Përgjithshme të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Lumnije Demi, për të diskutuar bashkëpunimin në promovimin e mandatit të Agjencisë, veçanërisht në mbrojtjen e të dhënave personale dhe të qytetarëve në sigurimin e qasjes në dokumente publike.



Në Forumin e Grave, Paqes dhe Sigurisë, OJQ ACDC mori pjesë në një sesion 'pitch' si OSHC të kualifikuara për të prezantuar idenë e projektit të paraqitur për skemën e mbështetjes së OSHC-ve të mbështetur nga GIZ. Një kënd i veçantë i'u kushtua OSHC-ve të kualifikuara, duke ofruar një hapësirë për promovimin e organizatave pjesëmarrëse.

## Sesion informativ nga Dhomat e Specializuara të Kosovës

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DSK), në bashkëpunim me OJQ ACDC, mbajtën një sesion informues në muajin prill. Gjatë ngjarjes, përfaqësuesit e DSK-së bënë një prezantim gjithëpërfshirës duke theksuar misionin dhe operacionet e Dhomave, duke u fokusuar në procedurat ligjore lidhur me krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe veprat tjera penale.



## ACDC monitoron referendumin në komunat veriore

OJQ ACDC, si anëtare e Demokracisë në Veprim, një koalicion i OShC-ve të angazhuara në aktivitetet e monitorimit të zgjedhjeve, vëzhgoi procesin e votimit në lidhje me shkarkimin e kryetarëve të katër komunave veriore në të gjitha vendvotimet. Pas procesit zgjedhor, Demokracia në Veprim ka lëshuar një komunikatë për media ku thuhet se procesi i votimit është karakterizuar me mungesë të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe se kushtet teknike në disa qendra votimi nuk përmbushin standardet e kërkuara për procesin e votimit. Lexoni deklaratën e plotë në faqen tonë të internetit.



SRB



ALB



ENG

Drejtori Ekzekutiv i OJQ-së ACDC, Dushan Radaković, drejtori i programit, Aleksandar Rapajiq, dhe menaxheri i programit, Slobodan Stoshiq ishin të angazhuar në mënyrë aktive para dhe pas referendunit, duke ndarë njohuritë e tyre me media të ndryshme.

### ACDC në Media

Dushan Radaković për RTK2 për referendumin



Dushan Radaković për Kossev për referendumin



Aleksandar Rapajiq për Kosovo Online për referendumin



Slobodan Stoshiq për Kosova Online për vendosjen e kamerave në referendum



Slobodan Stoshiq në RTK2 për referendumin



Slobodan Stoshiq për Kosovo Online për heqjen e vizave për serbët nga Kosova



Dushan Radaković për Kossev për referendumin

